

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

1. Informacion i Përgjithshëm

Shoqëria Grant Thornton është shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar e krijuar me 23.07.2009 në përputhje me Ligjin “Për Shoqëritë Tregtare”.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është dhënia e shërbimeve të auditimit, konsulencës për taksat dhe shërbime kontabiliteti.

Administrator i shoqërisë është Z. Kledian Kodra. Me 31 dhjetor 2024 shoqëria kishte 40 punonjës (31 dhjetor 2023: 38 punonjës).

Selia qendrore e shoqërisë është në adresën: Rr “Sami Frashëri”, Kompleksi T.I.D, Shk. B, Kati 1, Tiranë. Ajo është regjistruar si person i tatueshëm në rrethin e Tiranës me numër identifikimi të personit të tatueshëm K91923007M.

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2024 janë aprovuar nga administratori më 27 mars 2025.

2. Bazat e përgatitjes dhe deklaratës së pajtueshmërisë

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Shoqëria ka përgatitur këto pasqyra financiare në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin në Shqipëri. Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (“SKK”). Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura, përveçse kur shprehet ndryshe. Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në ligjin nr. 25/2018, datë 10 maj 2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Konkretisht, Shoqëria është udhëzuar nga SKK 2, i cili zbatohet për këtë shoqëri dhe shoqëritë e tjera të ngjashme.

Më poshtë janë paraqitur parimet kryesore të politikave kontabël në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Pasqyrat financiare janë prezantuar në monedhën Lek.

2.2 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Politikat kryesore kontabël janë të paraqitura më poshtë.

2.3 Monedha funksionale dhe e raportimit

Monedha funksionale e Shoqërisë është Lek, që është edhe monedha kryesore në mjedisin kryesor ekonomik ku Shoqëria operon. Për qëllime të raportimit, këto pasqyra janë përgatitur dhe paraqitur në monedhën shqiptare Lek.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Rezultati dhe pozicioni financiar i Shoqërisë konvertohen në monedhën raportuese duke konvertuar aktivet dhe detyrimet me kursin e datës së raportimit dhe të ardhurat dhe shpenzimet me kursin në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e pasqyrës së pozicionit financiar janë përkthyer në lekë duke përdorur kursin e këmbimit të asaj date. Humbjet dhe fitimet që rezultojnë nga kurset e këmbimit janë njohur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

2.4 Përdorimi i gjykimeve dhe i vlerësimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat pasardhëse që preken nga ky ndryshim.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

2.5 Parimi i vijmësisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me parimin e vijmësisë, i cili supozon se Shoqëria do të vazhdojë aktivitetin e saj për një të ardhme të parashikueshme. Në kryerjen e këtij gjykimi, drejtimi realizoi një analizë të hollësishme duke marrë në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat në dispozicion dhe pozicionin financiar të Shoqërisë, qëllimet aktuale, përmirësimin e pritshëm të përfitimit të operacioneve dhe disponueshmërinë e burimeve financiare, në përputhje me parimin e vijmësisë në të ardhmen e parashikueshme. Në të ardhmen e parashikueshme Drejtimi merr në konsideratë të gjitha informacionet e disponueshme për të ardhmen, të cilat janë të paktën, por nuk kufizohet në 12 (dymbëdhjetë) muaj nga përfundimi i periudhës së raportimit. Përfundimi nga analiza e mësipërme është që Shoqëria nuk përballë me ndonjë problem për të vijuar aktivitetin e saj dhe nuk parashikon ndonjë të tillë deri në fund të vitit pasardhës.

3. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kryesore kontabël të miratuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha vitet e paraqitura, përveç nëse është shprehur ndryshe.

Kurset e këmbimit të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare për monedhat kryesore si më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë si vijon:

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Humbjet dhe fitimet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve dhe nga rivlerësimi i zërave monetare në monedhë të huaj më kursin e fundvitit njihen në fitim ose humbje. Si më poshtë janë vendosur kurset në datën e raportimit.

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Euro	98.15	103.88
Usd	94.26	93.94

3.2 Instrumentat Financiare

Instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar për një shoqëri, si dhe një detyrim financiar ose instrument kapitali për një shoqëri tjetër. Një njësi duhet të njohë një aktiv financiar ose një detyrim financiar vetëm kur njësi bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit financiar dhe maten fillimisht me vlerën e drejtë të rregulluar me kostot e transaksionit, përveç atyre të mbajtura me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes të cilat njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe kostot e transaksionit shpenzohen në fitim ose humbje.

Për huatë e pagueshme të njohura në datën e raportimit për të cilat ka pasur shkelje të afateve ose mospagim të principalit, interesit, apo shkelje të kushteve të shlyerjes që nuk janë korrigjuar në datën e raportimit, shoqëria duhet të japë informacion shpjegues për detajet e kësaj shkelje ose mospagese, vlerën kontabël të huave të pagueshme në datën e raportimit, nëse shkelja ose mospagesa është korrigjuar, ose nëse afatet e huasë së pagueshme janë rinegociuar, përpara se pasqyrat financiare të aprovoheshin për publikim. Shoqëria nuk ka hua të pagueshme dhe, për pasojë, nuk ka as hua për të cilat ka tejkalar afatin, apo shkelje të kushteve të shlyerjes që kërkojnë korrigjim ose rinegocim.

3.2.1 Aktivet financiare

Në përputhje me pasqyrat financiare të paraqitura, shoqëria nuk ka aktive financiare për periudhën raportuese. Shoqëria klasifikon aktivet e saj financiare në kategoritë e mëposhtme: aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, huatë dhe llogaritë e arkëtueshme, aktivet financiare të mbajtura deri në maturim dhe aktivet financiare të vlefshme për shitje. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin janë marrë investimet. Drejtimi përcakton klasifikimin e investimeve të tij në njohjen fillestare dhe e rivlerëson këtë në çdo datë raportimi.

a) Aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbje

Në këtë kategori përfshihen dy nën-kategori: aktivet financiare të mbajtura për tregtim dhe ato të klasifikuara me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes që në fillim. Një aktiv financiar është i klasifikuar në këtë kategori nëse është blerë me qëllim për t'u shitur në një periudhë afatshkurtër, nëse ai përbën një pjesë të portofolit të aktiveve financiare për të cilat ka evidencë për realizimin e fitimeve afatshkurtra. Shoqëria nuk ka asnjë aktiv të klasifikuar në këtë kategori.

Paragrafi si më sipër nuk gjen zbatim për shoqërinë Grant Thornton Shpk, pasi shoqëria nuk ka aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbje për periudhën raportuese.

b) Huatë dhe të arkëtueshmet

Huatë dhe të arkëtueshmet janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv letrash me vlerë, përveç atyre që Shoqëria kërkon t'i shesë në periudhë afatshkurtër ose janë përcaktuar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Huatë dhe të arkëtueshmet njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe pastaj maten me koston e amortizuar duke përdorur koston efektive të interesit, duke zbritur provizionin për zhvlerësim. Një provizion për zhvlerësim për huatë dhe llogaritë e arkëtueshme krijohet kur ka evidencë objektive që Shoqëria nuk do jetë në gjendje të arkëtojë të gjithë shumat në përputhje me kushtet e tyre në momentin fillestar. Mjetet monetare, të arkëtueshme nga kontrata e ndërtimit, të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme bëjnë pjesë në këtë kategori të aktiveve financiare.

c) Aktive financiare të mbajtura deri në maturim

Aktivete financiare të mbajtura deri në maturim janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe me afat maturimi fiks, përveç atyre që plotësojnë kushtet e përkufizimit të huave dhe të arkëtueshmeve, që manaxhimi i kompanisë ka qëllimin dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim. Këto aktive njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me vlerën e amortizuar duke përdorur koston efektive të interesit, duke zbritur provizionin për zhvlerësim nëse ka. Një provizion për zhvlerësim për aktive financiare të mbajtura deri në maturim krijohet kur ka evidencë objektive që Shoqëria nuk do jetë në gjendje të arkëtojë të gjithë shumat në përputhje me kushtet e tyre origjinale. Shoqëria nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategori në datën e raportimit.

Paragrafi si më sipër nuk gjen zbatim për shoqërinë Grant Thornton Shpk, pasi shoqëria nuk ka aktive financiare të mbajtura deri në maturim për periudhën raportuese.

d) Aktive financiare të disponueshme për shitje

Aktivete financiare të disponueshme për shitje janë aktive financiare jo derivative të klasifikuara në këtë kategori ose që nuk janë të klasifikuara në ndonjë kategori tjetër. Shoqëria nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategori në datën e raportimit.

Paragrafi si më sipër nuk gjen zbatim për shoqërinë Grant Thornton Shpk, pasi shoqëria nuk ka aktive financiare të disponueshme për shitje për periudhën raportuese.

e) *Njohja fillestare e aktiveve financiare*

Një aktiv financiar njihet nga shoqëria në momentin kur shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuese të instrumentit. Kur një aktiv financiar njihet për herë të parë, një njësi duhet ta masë atë me vlerën e drejtë, e cila zakonisht është çmimi i transaksionit, duke përfshirë edhe kostot e transaksionit. Përfshirja bëjnë rastet kur marrëveshja ka natyrën e një transaksioni financiar. Një transaksion financiar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përtej afateve normale të tregtisë ose kur ajo është financuar me një normë interesi që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, njësi duhet të masë aktivin financiar me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Paragrafi si më sipër nuk gjen zbatim për shoqërinë Grant Thornton Shpk, pasi shoqëria nuk ka aktive financiare për periudhën raportuese.

f) *Matja e mëposhtme e aktiveve financiare*

Në fund të çdo periudhe raportimi, një shoqëri duhet të matë aktivet financiare duke përdorur vlerën e drejtë dhe të njohë ndryshimet në këtë vlerë si fitim ose humbje, përveç instrumenteve të kapitalit që nuk janë të tregtuara publikisht dhe për të cilat vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, si dhe kontratave të lidhura me këto instrumente, të cilat, nëse realizohen, do të maten me koston e tyre të pakësuar nga zhvlerësimi.

Nëse një matje e besueshme e vlerës së drejtë nuk është më e disponueshme për një aktiv financiar që nuk është i tregtuar publikisht, por që matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, vlera e drejtë në datën e fundit kur instrumenti ishte i matshëm në mënyrë të besueshme, konsiderohet si kosto e instrumentit. Shoqëria do të vazhdojë ta vlerësojë këtë instrument sipas koston së tij, të pakësuar nga zhvlerësimi, derisa të bëhet e mundur matja e besueshme e vlerës së drejtë.

Paragrafi si më sipër nuk gjen zbatim për shoqërinë Grant Thornton Shpk, pasi shoqëria nuk ka aktive financiare për periudhën raportuese.

g) *Çregjistrimi i aktiveve financiare*

Një shoqëri duhet të çregjistrojë një aktiv financiar nëse ndodh njëra prej situatave të mëposhtme: (a) kur të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi skadojnë ose shlyhen, (b) kur njësi i transferon një pale tjetër pothuajse të gjitha risqet dhe përfitimet që lidhen me zotërimin e aktivin, ose (c) kur, pavarësisht se njësi ka ruajtur disa risqe dhe përfitime të rëndësishme, ka transferuar kontrollin e aktivit tek një palë tjetër, e cila ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësinë e tij pa kufizime dhe mund ta ushtrojë këtë aftësi në mënyrë të njëanshme. Në këtë rast, njësi është e detyruar të çregjistrojë aktivin nga bilanci dhe të njohë çdo të drejtë të mbajtur apo detyrim të krijuar në kuadër të transferimit.

Paragrafi si më sipër nuk gjen zbatim për shoqërinë Grant Thornton Shpk, pasi shoqëria nuk ka aktive financiare për periudhën raportuese.

3.2.2 Detyrimet financiare

Detyrimet financiare të shoqërisë përfshijnë llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme ndaj aksionarëve. Detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e tyre të drejtë të përshtatur me kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e tyre. Detyrimet financiare më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Gjatë periudhës raportuese shoqëria Grant Thornton Shpk nuk ka patur detyrime financiare.

3.2.3 Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shumt e tyre neto raportohen në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë ligjore e zbatueshme për të kompensuar shumt e njohura dhe ka qëllim për t'i vendosur mbi bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

3.3 Shpenzimet e tjera operative

Shpenzimet operative njihen në fitim ose humbje gjatë përdorimit të shërbimit ose në datën në të cilën ato kanë ndodhur. Shpenzimet për garancitë njihen dhe ngarkohen kundrejt provizionit përkatës në momentin që njihet e ardhura e lidhur me to.

3.4 Qiraja

Shpenzimet e qirave, në të cilat një pjesë e madhe e riskut dhe përfitimeve të pronësisë mbarten nga qiramarrësi, klasifikohen si qira financiare. Pagesat e kryera për qiranë financiare (neto nga ndonjë përfitim të marrë nga qiradhënësi) ngarkohen në fitim ose humbje me metodë lineare përgjatë periudhës së qirasë.

Faktorët të cilat konsiderohen përfshijnë gjatësinë e afatit të qirasë në lidhje me jetën ekonomike të aktivit, vlerën aktuale të pagesave minimale të qirasë në lidhje me vlerën e drejtë të aktivit, dhe nëse Shoqëria merr pronësinë e aktivit në fund të afatit të qirasë. Të gjitha qiratë e tjera trajtohen si qira operative. Gjatë periudhës raportuese shoqëria Grant Thornton Shpk ka vetëm kontrata për qira operative. Pagesat për marrëveshjet e qirasë operative shoqëria i njeh si shpenzime në bazë lineare përgjatë afatit të qirasë.

3.5 Përfitimet e punonjësve

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj, depoziton kontributet fikse për llogari të punonjësve në fondet e pensioneve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Të gjithë pagesat dhe detyrimet njihen si shpenzim në periudhën në të cilën i takojnë.

3.6 Aktivet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Shoqëria njeh koston e një zëri të AAM-ve si një aktiv nëse dhe vetëm nëse: (a) aktivi kontrollohet nga shoqëria; (b) është e mundur që nga përdorimi i aktivit do të hyjnë në shoqëri përfitime të ardhshme ekonomike; (c) kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri. Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet në momentin e përftimit të tij nga blerja apo prodhimi.

Një element i AAM-së, që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar matet me kosto. Në kosto përfshihet kosto e blerjes duke përfshirë taksat e importit dhe taksa të tjera të parimbursueshme, duke zbritur skontot tregtare, kosto të tjera të drejtpërdrejta që lidhen me sjelljen e aktivitetit në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij, sipas qëllimeve të shoqërisë dhe kostoja fillestare e vlerësuar e çmontimeve të ardhshme të një aktivi dhe të kthimit të terrenit, në të cilin ai ndodhet, në gjendjen fillestare. Nëse pagesa për AAM shtyhet përtej afateve normale të kredive për pagesë, në përcaktimin e koston së aktivitetit merret në konsideratë vlera aktuale e pagesës. Diferenca mes vlerës nominale dhe vlerës aktuale njihet si një shpenzim interesi përgjatë afatit të pagesës. Nëse përbërësit kryesorë të një AAM-je kanë, në mënyrë të konsiderueshme, jetë të dobishme të ndryshme, këto pjesë duhet të njihen fillimisht si elementë të veçantë të AAM-së, duke caktuar norma amortizimi të veçanta për secilin prej tyre, në varësi të jetës së tyre të dobishme.

(ii) *Vlerësimi i mëpasshëm*

Shoqëria ka zgjedhur si politikë të saj kontabël modelin e koston dhe e zbaton këtë model për të gjithë klasën e AAM-ve që vlerësohet. Sipas modelit të koston, në pasqyrën e pozicionit financiar një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

(iii) *Amortizimi*

Shoqëria e shpërndan vlerën e amortizueshme të një aktivi në bazë sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Vlera e amortizueshme e një elementi të AAM-së njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivi.

Amortizimi i një aktivi afatgjatë material fillon kur ai është i gatshëm për përdorim (d.m.th. kur është në kushtet dhe vendin e duhur) dhe vazhdon deri në amortizimin e plotë të vlerës së amortizueshme ose deri sa ai çregjistrohet, del nga përdorimi ose riklasifikohet si i mbajtur për shitje.

Metoda e zgjedhur e amortizimit duhet të pasqyrojë sistematikisht mënyrën se si do të realizohen nga shoqëria përfitimet ekonomike të ardhshme të aktivitetit afatgjatë, të përfuara gjatë jetës së dobishme të tij. Metodatat më e zakonshme e amortizimit që përdoret në praktikë është metoda lineare. Shoqëria në periudhat e mëparshme raportuese ka përdorur metodën mbi vlerën e mbetur të aktivitetit, por duke filluar nga viti 2024 ka ndryshuar mënyrën e vlerësimit të aktiveve dhe ka kaluar në metodën lineare, duke gjykuar këtë metodë si matës më të mirë të konsumit të aktivitetit. Përdorimi i metodave të tjera merret në konsideratë në rast se ato pasqyrojnë në mënyrë më objektive shpërndarjen e përfitimeve të ardhshme ekonomike gjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

Normat vjetore të amortizimit të aplikuara janë si më poshtë:

Aktive të qëndrueshme	%
Ndërtesa	5
Makineri dhe pajisje	20
Automjete	20
Pajisje zyre dhe të tjera	20
Komputera dhe pajisje IT	25

Jetëgjatësia e aktiveve dhe vlera e mbetur rishikohet në çdo datë raportimi.

Aktive afatgjata jomateriale (AAJM) janë aktive të identifikueshme jomonetare pa përmbajtje fizike, të mbajtura për qëllim prodhimin e produkteve ose furnizimin e mallrave ose shërbimeve, për t'ua dhënë me qira të tretëve ose për qëllime administrative. Aktivet afatgjata jomateriale që kanë një jetë të përcaktuar maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet mbi koston e blerjes së aktivit. Shuma e amortizimit kalon në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë lineare përgjatë jetës së aktivit.

Aktive afatgjata jo materiale	%
	15

3.7 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrim i kushtëzuar është një detyrim që mund të krijohet nga ngjarje të shkuara, ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nga ndodhja ose mosndodhja e një ose disa ngjarjeve të ardhshme të pasigurta, që nuk janë nën kontrollin e plotë të shoqërisë. Detyrimet e kushtëzuara nuk do të njihen, përveç provizioneve për detyrimet e kushtëzuara të një shoqërie të blerë në një kombinim biznesi.

Një aktiv i kushtëzuar është një kërkesë e mundshme që lind nga ngjarje të shkuara dhe ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nëse ndodh ose jo një ose disa ngjarje të ardhshme të pasigurta, të cilat nuk janë nën kontrollin e plotë të shoqërisë. Shembull i një kërkesë të mundshme është një ankesë që shoqëria i ka paraqitur një shoqërie tjetër, realizimi i së cilës varet nga rezultati i proceseve gjyqësore. Shoqëria duhet të japë informacion shpjegues për një aktiv të kushtëzuar, në rastet kur është e mundshme një hyrje e përfitimeve ekonomike.

3.8 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së shoqërisë, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitalit (këtu nuk përfshihen rritjet, që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital).

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që shoqëria do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Një shoqëri duhet të masë të ardhurat me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve përfshin të ardhurat totale të periudhës kontabël.

3.9 Provizionet

Provizioni është një detyrim aktual, për të cilin koha e shlyerjes ose shuma janë të pasigurta. Shoqëria e njeh provizionin si një detyrim në pasqyrën e pozicionit financiar dhe shumën e tij si një shpenzim, përveç rastit kur në një nga standardet e tjera kërkohet që kostoja të njihet si pjesë e koston së një aktivit si p.sh. inventar

ose tokë, ndërtesa, makineri dhe pajisje. Shoqëria njih provizionin vetëm kur ngjarja detyruese ka ndodhur para datës së raportimit. Që një ngjarje të quhet detyruese, është e nevojshme që ajo të krijojë një detyrim ligjor ose konstruktiv për shoqërinë, dhe që shoqëria nuk ka asnjë alternativë tjetër për shmangien e këtij detyrimi, përveç shlyerjes së tij.

Shuma e njohur si provizion është vlerësimi më i saktë i mundshëm i shpenzimeve të nevojshme për shlyerjen e detyrimit ekzistues të mundshëm, e vlerësuar kjo në datën e raportimit. Për provizionet afatgjata, aplikohet vlera aktuale e shpenzimeve të pritshme, duke skontuar me një normë që pasqyron vlerën në kohë të parasë.

Shoqëria i rishikon provizionet në çdo datë të raportimit dhe i rregullon ato për të pasqyruar vlerësimin më të mirë aktual të shumës që do të kërkohet për të shlyer detyrimin në atë datë të raportimit. Një provizion përdoret vetëm për ato lloj shpenzimesh, për të cilat ai është njohur fillimisht. Asnjë shpenzim tjetër, që nuk ka lidhje me provizionin e krijuar, nuk duhet të kompensohet kundrejt tij, pasi kjo do të dëmtonte karakterin objektiv të pasqyrave financiare të një shoqërie.

3.10 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përveç rasteve kur lidhet me zërat e njohur direkt në kapitalin neto ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur përqindjen e tatimit të miratuar në datën e raportimit (shkalla e tatimit mbi fitimin për vitin fiskal 2024 është 15%). Nëse pagesat e tatimit për periudhat aktuale/kaluara tejkalojnë shumën e pagueshme, tejkalimi regjistrohet si aktiv tatimor i rimbursueshëm.

4. Manaxhimi i rrezikut financiar

4.1 Faktorët e rrezikut financiar

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare që përfshijnë rrezikun e kreditit dhe rrezikun e lidhur me efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të monedhave të huaja dhe normat e interesit. Manaxhimi i rrezikut të shoqërisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe synon të minimizojë efektet potenciale të kundërta mbi performancën e biznesit të Shoqërisë.

(a) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes si pasojë e ndryshimit të çmimeve, kursit të këmbimit dhe normës së interesit në treg. Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit Shoqëria është e ekspozuar në një moment të caktuar varet nga kushtet në të cilat ndodhet tregu, pritshmëritë për çmimet në të ardhmen ose lëvizjet në normat e interesit të tregut, përbërja e aktiveve materiale të shoqërisë dhe kontratat, në të cilat Shoqëria është përfshirë.

(b) Rreziku i kursit të këmbimit

Një transaksion në monedhë të huaj në njohje, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëhershëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e transaksionit. Data e transaksionit është data kur transaksioni fillimisht plotëson kushtet për njohjen në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit.

Një shoqëri duhet të deklarojë monedhën në të cilën paraqiten pasqyrat financiare. Kur monedha raportuese është e ndryshme nga monedha funksionale, një shoqëri duhet ta deklarojë këtë fakt dhe duhet të japë informacion shpjegues për monedhën funksionale dhe arsyen e përdorimit të një monedhe raportuese të ndryshme.

Shoqëria operon dhe është e ekspozuar ndaj kursit të këmbimit me valutat e huaja, veçanërisht me monedhën Euro. Rreziku i kursit të këmbimit vjen kur ka njohje të transaksioneve tregtare si aktive ose detyrime në një monedhë e cila është e ndryshme nga monedha funksionale e Shoqërisë. Shoqëria nuk e diversifikon ekspozimin ndaj këtij lloji rreziku sepse nuk pret humbje të konsiderueshme si pasojë e luhatjeve të kursit të këmbimit me monedhat e huaja kerabasuar me kursin në datën e raportimit.

(c) Rreziku i kreditit

Shoqëria nuk ka ekspozim të rëndësishëm ndaj rrezikut të kreditit që mund të ndikojë në performancën financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023.

(d) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që një shoqëri do të përballet me vështirësi për të përmbushur detyrimet që lidhen me pasivet financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj nevojave të përditshme për burime monetare, kryesisht për të shlyer detyrimet e krijuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj normal. Drejtimi monitoron çdo ditë, javë dhe muaj duke bërë parashikime për flukset e parave.

5. Mjetet monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë janë të detajuara si më poshtë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Mjete monetare në bankë	6,114,505	1,162,882
Banka në lekë	2,284,341	200,210
Banka në valutë të huaj	3,830,162	962,672
Mjete monetare në arkë	20,458	77,161
Arka në lekë	8,680	74,792
Arka në valutë të huaj	11,778	2,369
Totali	6,134,961	1,240,043

6. Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit

Llogaritë e arkëtueshme në 31 Dhjetor 2024 janë të detajuara si më poshtë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Llogari të arkëtueshme	20,643,179	19,497,620
Provizion	(6,242,034)	(4,368,602)
Totali	14,401,145	15,129,018

Llogaritë e arkëtueshme përbëhen nga të arkëtueshmet nga partnerët e Grant Thornton Sh.p.k nga aktiviteti kryesor i biznesit, i cili është shitja e produkteve këtyre partnerëve.

7. Të arkëtueshme të tjera

Të arkëtueshmet e tjera në 31 Dhjetor 2024 janë të detajuara si më poshtë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Garanci dhënë të tretëve	448,430	515,286
Abonim i parapaguar dhe anëtarësime	26,135	29,274
Tatimi mbi fitimin	-	2,596,472
Të tjera	1,447,307	1,254,058
Hua ndaj Grant Thornton Montenegro	5,398,250	3,116,400
Totali	7,320,122	7,511,490

Grant Thornton Sh.p.k.
Shënimet për Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

8. Aktivet afatgjata materiale

Aktivt Afatgjata Materiale janë të detajuara si më poshtë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Mobilje dhe pajisje zyre		Pajisje informatike		Mjete transporti		Përmirësime të ambienteve me qira		Aktive jo financiare		Totali	
	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK
Aktivt me kosto												
Gjendja më 1 janar 2024	4,600,678		6,781,916		863,003		3,369,512		969,731		16,584,839	
Shtesat	68,332		1,063,896		-		-		-		1,132,230	
Pakësimet	-		-		-		(2,470,496)		-		(2,470,497)	
Gjendja më 31 dhjetor 2024	4,669,010		7,845,812		863,003		899,016		969,731		15,246,572	
Amortizimi												
Gjendja më 1 janar 2024	2,758,062		3,617,523		802,981		836,025		708,582		8,723,173	
Shtesat	383,673		933,291		13,591		62,991		53,471		1,447,017	
Pakësimet	-		-		-		-		-		-	
Gjendja më 31 dhjetor 2024	3,141,735		4,550,814		816,572		899,016		762,053		10,170,190	
Vlera e mbetur më 1 janar 2024	1,842,615		3,164,392		60,022		2,533,487		261,149		7,861,667	
Vlera e mbetur më 31 dhjetor 2024	1,527,275		3,294,999		46,431		-		207,678		5,076,383	

Grant Thornton Sh.p.k.

Shënimet për Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë përveç kur përcaktohet ndryshe)

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Mobilje dhe pajisje zyre LEK	Pajisje informatike LEK	Mjete transporti LEK	Përmirësim të ambienteve me qira LEK	Aktive jo financiare LEK	Totali LEK
Aktivët me kosto						
Gjendja më 1 janar 2023	4,098,070	6,037,386	863,003	3,369,512	969,731	15,337,701
Shtesat	502,607	744,530	-	-	-	1,247,138
Pakësimet	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	4,600,677	6,781,916	863,003	3,369,512	969,731	16,584,839
Amortizimi						
Gjendja më 1 janar 2023	2,343,123	2,637,928	778,061	702,684	634,112	7,095,908
Shtesat	414,938	979,595	24,920	133,341	74,470	1,627,265
Pakësimet	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	2,758,061	3,617,523	802,981	836,025	708,582	8,723,173
Vlera e mbetur më 1 janar 2023	1,754,947	3,399,457	84,942	2,666,828	335,619	8,241,793
Vlera e mbetur më 31 dhjetor 2023	1,842,616	3,164,393	60,022	2,533,487	261,149	7,861,667

Grant Thornton Sh.p.k.

Shënimet për Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

9. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Llogaritë e pagueshme janë të detajuara si më poshtë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të pagueshme ndaj palëve të treta	367,695	429,547
Shpenzime të llogaritura	2,752,630	385,603
Palë të lidhura	376,896	398,899
Dividend i pagueshëm	1,963,076	7,883,100
Të tjera të pagueshme	764,362	707,334
Totali	6,224,659	9,804,483

10. Të pagueshme ndaj detyrimeve tatimore

Të pagueshme për detyrime tatimore janë të detajuara si më poshtë më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të pagueshme ndaj TVSH	1,092,870	1,549,554
Të pagueshme ndaj Tatimit në burim	93,449	79,709
Të pagueshme ndaj sigurimeve shoqërore	1,190,015	1,219,677
Të pagueshme ndaj TAP	564,864	700,082
Të pagueshme ndaj Tatimi mbi fitimin	339,995	-
Totali	3,281,193	3,549,022

11. Kapitali

Grant Thornton është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me kapital prej 1,908,100 Lekë. Kuotat e kapitalit janë 2 dhe njera përfaqëson 20% të kapitalit dhe zotërohet nga shoqëria e auditimit Grant Thornton Consulting Doo, Shkup, Maqedoni dhe tjetra kuote përfaqëson 80% të kapitalit dhe zotërohet nga Z. Kledian Kodra.

12. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Shitjet e Shoqërisë janë të detajuara si më poshtë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Shitjet	136,832,902	119,668,129
Të ardhura të tjera	117,605	267,559
Totali	136,950,507	119,935,688

Grant Thornton Sh.p.k.

Shënimet për Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

13. Shpenzime të personelit

Shpenzime e personelit janë të detajuara si më poshtë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Paga bruto	62,956,691	63,338,346
Kontribute shoqërore dhe shëndetësore	8,283,973	7,918,598
Totali	71,240,664	71,256,944

14. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit janë të detajuara si më poshtë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Shpenzime antarësimi dhe ente rregullator	4,192,375	4,468,072
Qira	4,682,279	5,249,790
Shpenzime konsulence	4,844,384	2,737,905
Shpenzime nga kontratat e bashkëpunimit	6,693,054	548,610
Shpenzime IT	2,862,435	4,529,929
Shpenzime utilitare	593,034	566,781
Mirëmbajtje dhe shpenzime sigurimi	895,723	625,877
Udhëtime dhe dieta	1,057,244	1,457,260
Kancelari	867,255	793,615
Shpenzime postare dhe komunikacioni	391,746	524,051
Shpenzime personeli	728,842	783,202
Shpenzime transporti	381,920	199,492
Taksa lokale	146,575	49,500
Shpenzime trajnimit	292,729	165,808
Sponsorizime	677,174	288,865
Gjoha	14,422	18,786
Komisione bankare	153,347	184,939
Shpenzime të tjera	6,641,733	2,985,089
Totali	36,116,271	26,177,571

15. Të ardhura /shpenzime financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare janë të detajuara si më poshtë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Fitim nga kursi i këmbimit	498,231	2,138,840
Humbje nga kursi i këmbimit	(2,639,328)	(3,106,277)
Të ardhura financiare, neto	(2,141,097)	(967,437)

16. Shpenzime të tatimit mbi fitimin

Shpenzime të tatimit mbi fitimit për aktivitetin në Shqipëri analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Fitimi / (Humbja) e vitit	26,005,458	19,906,472
<i>Shpenzime të pazbritshme</i>		
Gjoha	14,422	18,786
Shpenzime utilitare	417,931	297,964
Shpenzimi për arzetimin e personelit	318,343	422,298
Shpenzime të tjera	564,640	869,948
Shpenzime borxh i keq	1,970,050	1,216,593
Shpenzime mirëmbajtje dhe riparime	327,486	13,000
Shpenzime udhëtimi	247,051	56,086
Shpenzime karburanti	52,202	43,500
Totali i shpenzimeve të pazbritshme	3,912,125	2,938,175
Fitimi tatimor	29,917,583	22,844,647
Tatim fitimi 15% (2024:15%)	15%	15%
Shpenzimi për tatim fitimin	4,487,637	3,426,697

Në përputhje me rregulloren e taksave në Shqipëri, norma e aplikueshme e tatimit mbi të ardhurat për vitin 2025 është 15% (2024: 15%). Deklaratat tatimore deklarohen çdo vit, por fitimet ose humbjet e deklaruara për qëllime tatimore mbeten të përkohshme deri në kohën kur autoritetet tatimore shqyrtojnë të dhënat e kthimit dhe të dhënat e tatimpaguesit dhe lëshohet një vlerësim përfundimtar.

17. Transaksionet e palëve të lidhura

Një palë quhet e lidhur me një entitet nëse: (A) drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet një ose më shumë ndërmjetësve, pala: (i) kontrollon, kontrollohet ose është nën kontroll të përbashkët me entitetin (kjo përfshin Shoqëritë mëmë, filialet dhe shoqëritë e kontrolluara të tjera); (ii) ka një interes në njësinë ekonomike që i jep ndikim të rëndësishëm mbi njësinë ekonomike; Ose (iii) ka kontroll të përbashkët mbi njësinë ekonomike; (B) pala është një bashkëpunëtor i njësisë ekonomike; (C) pala është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën shoqëria është një sipërmarrje; (D) pala është anëtare e personelit kryesor të drejtimit të njësisë ekonomike ose prindit të saj; (E) pala është një anëtar i ngushtë i familjes së çdo individi të përmendur në (a) ose (d); (F) pala është një entitet që kontrollohet, kontrollohet bashkërisht ose ndikohet në mënyrë të konsiderueshme nga, ose për të cilën zotëron një të drejtë të rëndësishme votimi në entitetin e sipërpërmendur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (G) pala është një skemë e përfitimit pas punësimit në dobi të punonjësve të njësisë ekonomike ose të çdo njësie ekonomike që është palë e ndërlidhur e njësisë ekonomike. Një transaksion i palës së lidhur është një transferim i burimeve, shërbimeve ose detyrimeve ndërmjet palëve të lidhura, pavarësisht nëse është caktuar një çmim mbi transaksionin.

Grant Thornton Sh.p.k.

Shënimet për Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

Më 31 dhjetor 2024, gjendjet me palët e lidhura analizohen si më poshtë:

Transaksionet me palët e lidhura gjatë vitit financiar janë përmbledhur si më poshtë:

	Të arkëtueshme LEK	Detyrime LEK	Të ardhura LEK	Kosto LEK
31 Dhjetor 2024				
Grant Thornton Doo		-	482,786	3,858,363
Grant Thornton Consulting Doo		-		-
Grant Thornton Doo Podgorica	5,398,250			
	5,398,250	-	482,786	3,858,363
31 Dhjetor 2023				
Grant Thornton Doo		-		4,171,902
Grant Thornton Consulting Doo		-	913,570	-
Grant Thornton Doo Podgorica	3,116,400			
	3,116,400	-	913,570	4,171,902

18. Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në çështje ligjore. Në gjykimin e drejtimit, Shoqëria nuk do të ketë ngjarje me peshë të konsiderueshme për të ndikuar në pozicionin financiar të saj ose për të ndryshuar vlerën neto të aktiveve.

19. Ngjarje pas datës së raportimit

Drejtimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje tjetër pas datës së raportimit që do të kërkonte të ndryshoheshin shënimet në pasqyrat financiare.